



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 175, datë 01.12.2023

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË PARQEVË URBANE DHE RIORGANIZIMIN
E NDËRMARRJES RRUGA**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9 pikat 1.1 gërma a, b dhe ç, pika 1.4 gërmat a, dhe b, pika 1.7 gërma b, neni 23 pikat 4,5,8 dhe 9, neni 54 gërmat ç, d dhe dh, nenit 55, pikat 3 dhe 6, neni 64 gërmat c dhe j të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenit 9, shkronja “d”, e Ligjit nr.35/2023, datë 25.5.2023 për “Për Kompetencat për Caktimin e Pagave, Trajttimeve të Tjera Financiare dhe Përfitimeve të të Punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të Pagës Bazë Minimale në Shkallë Vendi”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.80, datë 28.06.2021 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në varësi të Bashkisë së Durrës”; si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja Rruga, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Të miratojë krijimin e Agjencisë së Parqeve Urbane (APU), si institucion buxhetor në varësi të Bashkisë Durrës me një numër të përgjithshëm prej 131 (njëqind e tridhjetë e një) punonjësish me seli: Lagjja 15, Porto Romano, Durrës, tek vepra Eko Park.
2. Detyrat kryesore funksionale të kësaj Agjencie do të jenë si më poshtë vijon:
 - a) të administrojë, mirëmbajë, zhvillojë veprën Eko – Park, Parku Vala etj.
 - b) të administrojë mirëmbajtjen, zhvillimin, dhe zonat e gjelbërta të zonave të banimit brenda territorit të Bashkisë Durrës.
 - c) të menaxhojë prodhimin dhe furnizimin me lule dhe bimësi për çerdhet, kopshtet dhe shkollat nën administrimin e Bashkisë Durrës.
 - d) të mirëmbajë parqet, shëtitorët, lulishtet (stolat, koshat e vegjel), shatrvanet, dhe këndet e lojrave të qytetit të Durrësit (Shetitorja Taulantia, lulishtja tek Mauzoleumi i Deshmorëve, lulishtja hyrja e Durrësit, si dhe gjelbërimin dhe pemët në të gjitha akset rrugore të NJQV).
3. Kjo agjenci do të drejtohet nga drejtori, i cili emërohet nga Kryetari i Bashkisë.
4. Punonjësit e Agjencisë emërohen dhe lirohen nga detyra në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës, ndërsa për punonjësit aktualë të Sektorit të Gjelbërimit, të cilët transferohen pranë Agjencisë, zbatohen përcaktimet ligjore të këtij Kodi, që rregullojnë transferimin e marrëdhënieve të punës.
5. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Agjencisë, sipas lidhjes së pagave nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Miratimin e formatit të biletës hyresë në Eko-Park dhe Vala Park sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Miratimin e tarifave për aktivitetet sportive në Eko-Park dhe Vala Park si më poshtë vijon:

✓	Fusha e futbollit	1.000 Lekë / ora
✓	Fusha e Basketbollit	1.000 Lekë / ora
✓	Fusha e Tenisit	800 Lekë / ora
✓	Fusha Mini Kalceto	1.000 Lekë / ora
✓	Fusha Volejboli	1.000 Lekë / ora
✓	Climbing (ngjitje tek muri)	500 Lekë personi / dita
8. Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ndryshimet përkatëse në paketën Fiskale.



9. Miratimin e të drejtës së Agjencisë së Parqeve Urbane të lidhë marrëveshje me operatorë të tretë në funksion të aktivitetit të Agjencisë.
10. Kësaj Agjencie t'i bashkohet Sektori i Gjellbërimit aktualisht në varësi të Ndërmarrjes Rruga i përbërë nga 111 punonjës.
11. Të miratojë riorganizimin e Ndërmarrjes Rruga me një numër të përgjithshëm prej 121 punonjësish
12. Ndërmarrja Rruga duhet të kryejë të gjitha procedurat sipas legjislacionit në fuqi lidhur me procesin e transferimit të asetëve të Sektorit të Gjellbërimit sipas tabelës bashkëngjitur, nga Ndërmarrja Rruga tek Agjencia e Parqeve Urbane brenda datës 31.12.2023
13. Efektet financiare për krijimin e Agjencisë së Parqeve Urbane do të përballohen nga buxheti i bashkisë për vitin 2024. Agjencia e Parqeve Urbane do të administrojë në inventarin e saj të gjitha njësitë e sipërcituara.
14. Drejtoria e Buxhetit ngarkohet të kryej rialokimin e fondeve për Agjencinë e Parqeve Urbane brenda buxhetit të vitit 2024.
15. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Agjencisë, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni.
16. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja Rruga, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 04.12.2023


AGJENCIA E PARQEVE URBANE

FUSHA E VOLLEJBOLLIT

Tarifa: **1000 LEKE / ORA**

Nr. _____

DATA

ORA


AGJENCIA E PARQEVE URBANE


CLIMBING (NGJITJE TEK MURI)

Tarifa: **500 LEKE / PERSONI / DITA**

Nr. _____

DATA

ORA


BASHKIA DURRES
AGJENCIA E PARQEVE URBANE

Tarifa: **800 LEKE / ORA**

Nr. _____

DATA

ORA


AGJENCIA E PARQEVE URBANE


FUSHA MINI KALCETO

Tarifa: **500 LEKE / ORA**

Nr. _____

DATA

ORA


AGJENCIA E PARQEVE URBANE

FUSHA E FUTBOLLIT

Tarifa: **1000 LEKE / ORA**

Nr. _____

DATA

ORA


FUSHA E BASKETBOLLIT



DATA

ORA

LIDHJA NR.2

NIVELI PAGAVE PER PUNONJESIT E AGJENCISE SË PARQEVE DURRËS

A. PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË

	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emertetat e pozicioneve te punes	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Shtesa per vjetërsi	Paga për pozicion
1	Drejtor	1	2%	85 000
2	Zv.Drejtor	1	2%	80.000
3	Përgjegjës sektori	1	2%	70,000
4	Përgjegjës sektori operacional	1/2/3	2%	60.000
5	Specialist	1/2/3	2%	56,000

VLERA E SHITESËS SË NIVELIT TË KUALIFIKIMIT

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (leke/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK Master i Shkencave, Master i arteve Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14,000
2	Niveli 7 i KSHK Master profesional Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12,000
3	Niveli 6 i KSHK Bachelor Te barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10,000

Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në 2 % përqind, për çdo vit pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.

B. PUNONJËSIT MBËSHTETËS

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa	Shtesa për vjetërsi	Paga bazë mujore
1	Magaznier	IX	1%	44,800
2	Shofer automjeti transporti mbi 2,5 ton dhe mjeteve speciale	IX	1%	44,800
4	Shofer automjeti transporti deri ne 2.5 ton	IV	1%	42,500
5	Punonjës mirëmbajtje të profesioneve të ndryshme (mekanik, marangoz, elektrikist, hidraulik etj.)	IV	1%	42,500
6	Puntor shërbimi (gjelberim)	III	1%	41,800
7	Roje, punonjës pastrimi, sanitare	I	1%	40,000

B. II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë.



INVENTARI I SEKTORIT TE GJELBERIMIT

PAISJE + VEGLA PUNE		
Emertimi	Njesia	Sasia
Motokorrese bari	Cope	4
Filispanje korrese bari	Cope	4
Motosharre	Cope	4
Skela	Cope	2
Matrapik	Cope	2
Shkalle dyshe	Cope	1
Kompresor	Cope	1
Saldatrice	Cope	1
Fresibel	Cope	2
Krasitese ligustrash	Cope	1
Pompe sperkatje	Cope	2
Shkalle alumini	Cope	1

AUTOMJETE		
Emertimi	Targa	Sasia
Kamioncine Ford	AA125CN	1
Kamioncine NISSAN	AB318GX	1
Autobot Uji DAF	AB885JM	1
Autokulle NISSAN	AA133SN	1
Autobot Uji BENZ	AB901FR	1
Motogjenerator Autoboti		2
Gjenerator Autoboti Daf		2

VEPRA ARTI		
Emertimi	Njesia	Sasia
Puse	Cope	3
Shtatore MJ	Cope	1
Shtatore T.T + B.Dilan	Cope	2
Abstraksion	Cope	1
Peshakatari ne bronz	Cope	1
Guaska	Cope	2
Eva ne bronz	Cope	1
Shtatorja F.Noli	Cope	1
Balerinet	Cope	1
Statuja e Barit	Cope	1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 766/prot.
3

Durrës, më 13.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.175 datë 01.12.2023 “Për krijimin e Agjencisë së Parqeve Urbane dhe riorganizimin e Ndërmarrjes Rruga”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

